



KRIJONI NJË LISTË KONTAKTESH

Krijoni një listë të institucioneve përgjegjëse ose që kanë lidhje me emergjencat në rajonin tuaj. Vendoseni në një pikë të dallueshme në institucionin tuaj.

Disa kontakte të rëndësishme në Shqipëri janë:

- + Vullnetarët e ndihmës së parë (B-CARE): www.balkancare.net/contact
- + Personi përgjegjës në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare: _____
- + Zjarrfikësja: **I28**
- + Policia: **I26 (rrugore) / I27 (urgjenca) / I29**
- + Spitali më i afërt: _____
- + Qendra Operacionale Kombëtare për Emergjencat Civile: **04 273 190**
- + Drejtoria e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak: **04 363 465**

Kontakttoni institucionet e emergjencave:

- + Informojini ata mbi institucionin tuaj, vendndodhjen, misionin, drejtuesin, kontaktet dhe arsyen pse trashëgimia kulturore për të cilën përgjigjeni ka nevojë për përkujdesje të veçantë.
- + Kërkojini të vizitojnë institucionin tuaj gjatë ditës e natës, në mënyrë që ta njihin mirë, në rast emergjence.
- + Kërkojini që t'ju trajnojnë ju e kolegët tuaj. Disa nga kolegët tuaj mund të zgjidhen si vullnetarë për të ndihmuar në raste emergjencash.

JU NEVOJITET NDIHMË?

Trashëgimia Kulturore pa Kufij - Shqipëri (CHwB Albania) dhe Qendra për Zhvillimin Urban (Centar za urbani razvoj), Serbi, kanë trajnuar vullnetarë që mund të ndihmojnë në rajon në raste emergjencash që përfshijnë trashëgiminë kulturore. Nëse keni nevojë për ndihmë, mos ngurroni të kontrolloni listën e vullnetarëve në faqen tonë të internetit:

www.balkancare.net

Kjo fletëpalosje është prodhuar në kuadër të projektit Ndihma e parë për kulturën në Ballkan - Balkan Cultural Aid Response for Emergencies (B-CARE) financuar nga Prince Claus Fund nëpërmjet programit të tyre Cultural Emergency Response (CER).

SI TA MBROJMË TRASHËGIMINË KULTURORE NË RAST EMERGJENCE



B+CARE
BALKAN CULTURAL AID RESPONSE FOR EMERGENCIES

CHWB
Cultural Heritage without Borders
ALBANIA

udc

SWEDEN

Fonds
Prince Claus Fund for Culture and Development

UNDER THE PATRONAGE OF
ICCRUM

B+CARE
BALKAN CULTURAL AID RESPONSE FOR EMERGENCIES



MBANI NJË INVENTAR GATI

Nëse institucioni juaj nuk ka një inventar të koleksionit apo burimeve të tij, është e rëndësishme të filloni ta përpiloni, mundësisht duke e shoqëruar me përshkrim e fotografi të koleksionit/sitit.

Jepini përparësi elementëve të listës duke u bazuar në vlerat (historike, artistike, etj.) dhe cenueshmërinë e tyre (sa delikate/ të prekshme nga dëmtimi), sipas kategorive të mëposhtme:

- ✦ Rëndësi e lartë
- ✦ Rëndësi mesatare
- ✦ Rëndësi e ulët

Kjo listë do t'ju ndihmojë në dhënien e përparësisë veprimeve për evakuim, shpëtim apo rimëkëmbje në rast emergjence.

Dërgojeni këtë listë te adresa juaj e ajo e kolegëve tuaj dhe/ose mbajeni në arkivën tuaj elektronike.

Mbani një inventar edhe për njerëzit:

Në rast emergjence, gjatë orëve kur institucioni është i hapur për publikun, do jetë e nevojshme një listë e përditësuar e vizitorëve dhe stafit, sa persona ishin të pranishëm e ku mund të kenë qënë. Do jetë e nevojshme të identifikohen anëtarët e stafit me nevoja të veçanta.



PËRGATISNI NJË ÇANTË PËR RASTET E EMERGJENCAVE

Grumbulloni informacionin e mëposhtëm:

- ✦ Harta/planimetria e institucionin ku tregohen hyrjet, daljet, ashensorët, sistemet e furnizimit (ujë, gaz, elektricitet), alarmet, sistemin kundra zjarrit, telefonat dhe materialet e rrezikshme.
- ✦ Një fotografi ajrore të institucionit tuaj dhe zonës përreth për të analizuar rrugët e mundshme gjatë reagimit ndaj emergjencës. Bashkitë mund të kenë foto të tilla, përndryshe vizitoni albinfo.al.
- ✦ Kontaktet e anëtarëve të stafit. Fotografitë mund të ndihmojnë në identifikimin e personave të humbur apo të dëmtuar.
- ✦ Vendndodhja dhe lloji i materialeve të dëmshme, duke përfshirë koleksionin (municione, lëndë mjekësore, mostrave të mbrojtura, etj.)
- ✦ Vendndodhja e objekteve me përparësi, sipas inventarit tuaj. Këto mund të evidentohen në plan me shënime apo fotografi.
- ✦ Informacioni lidhur me kë duhet kontaktuar për çelësat.

Përgatitni disa kopje të kësaj çante:

- ✦ Njërën mbajeni vetë, njërën jepjauni kolegëve tuaj e një tjetër dergojeni te institucioni përgjegjës.
- ✦ Dërgoni çdo informacion digjital të kësaj çante në adresën tuaj dhe/ose ruajeni në arkivën tuaj elektronike.



LISTA E PAJISJEVE PËR RASTE EMERGJENCASH

Kjo është një listë me disa pajisje që mund t'ju vinë në ndihmë në rast se institucioni/siti juaj përballet me një situatë emergjente. Sigurohuni t'i kontrolloni ato rregullisht.

Pajisje të përgjithshme

- Plan i reagimit ndaj emergjencave
- Lista e kontakteve
- Aparat fotografik
- Formularët e dokumentimit
- Lapsa, shënues permanent
- Gërsërë (4 pale)
- Etiketa

Pajisje sigurie

- Shirit e tabela informuese
- Kutia e ndihmës së shpejtë
- Peceta antibakteriale
- Maskë kundra gaz
- Veshje e këpucë mbrojtëse
- Doreza pune
- Doreza plastike
- Syze mbrojtëse

Pajisje për largimin e ujit

- Sfungjerë prej celulose
- Sfungjerë me shkop
- Lecka për dyshemenë
- Kova
- Fshesa
- Furçë e kaci
- Letër thithëse
- Peshqirë

- Peceta letre
- Pelena
- Copa të vjetra

Energjia dhe drita

- Ndriçim për punë, struktura mbajtëse, llamba shtesë
- Tela elektrike, zgjatues
- Ndriçues dore e bateri shtesë
- Shirit

Pajisje pune

- Çekic
- Levë
- Kacavidë
- Kacavidë kryq
- Thikë, tehe shtese
- Pincë
- Çelës anglez

Enë mbajtëse, Mbështëse, Materiale për paketim

- Rul 4ml plastike-polietilen transparente
- 2 letra ngjitëse me mbajtëse
- Kutitë plastike jotransparente - e valëzuar
- Çanta plastike transparente
- Çanta për mbeturina të rënda
- Mbërthesa najloni
- 20 kuba druri 20cm

Lista ofruar nga: US National Park Service "Conserve O Gram"